

## GLOBALIZMI DHE PANDEMIA E KORONAVIRUSIT

Termi “*globalizëm*” është përdorur që në vitet ‘60-të, por mori përmasa më të mëdha pas viteve ‘90, pas shembjes së murit të Berlinit. Në fillim, ky term u përdor në fushën e ekonomisë dhe të ndërmarrjeve, por në vitin 1990 u shtri edhe në fusha të tjera, duke përfshirë gjerësisht edhe masmedian. Në mjaft studime të viteve ‘60-të, ky aspekt trajtohej si një “vizion i ri i botës”, me qëllim që njerëzit ta shihnin botën në mënyrë unike, si “një të tërë”, nën optikën e lindjes së një “shoqërie globale” dhe jo të fragmentarizuar në territore e popuj të ndryshëm, por si një tërësi planetare. Duke kaluar vitet, përpjekjet e studiuesve botërorë arritën në përfundimin se fjala më e përshtatshme për këtë lloj këndvështrimi, ishte termi “globalization” (globalizim).

Autori i njohur si “shpikës” i kësaj fjale, është sociologu kanadez M.Mc. Luhan, i cili që në vitin 1962, përdori fjalën mjaft të goditur “*fshati global*” në veprën e tij “La Galaxie Gutenberg”. Në vitet 1960-1970, autorë të tjerë anglo-saksonë, si Z. Brzezinski, J. Burton etj., ndihmuan në përhapjen dhe diskutimin e tezës së të ashtuquajturës “shoqëri botërore”. Duhet theksuar se në atë dhjetëvjeçar termi “globalizim” u përdor në kuptimin e tij të mirëfilltë, për të cilësuar fenomene plotësisht ekonomike. Ndërsa në mënyrë të personalizuar, emërtimi “globalizim” i atribuohet ekonomistit amerikan Ted Levi, i cili në vitin 1983 botoi artikullin “Globalization of Market” (Globalizimi i tregut), ku shpjegonte mënyrën e konvergimit të tregjeve në nivel botëror dhe krijimin e një forme të re ndërmarrjesh, që i cilësonte si “*Kompani globale*”.

Ky term po përdoret gjerësisht në çdo aspekt të jetës sonë të përditshme, sidomos pas viteve ‘90. Opinioni i përgjithshëm konvergon në katër arsye përcaktuese:

Së pari, shkakun më të rëndësishëm ishte rënia e murit të Berlinit, pra fundi i Luftës së Ftohtë ndërmjet dy kampeve, Lindjes dhe Perëndimit. Kjo ngjarje i tregoi botës, se modeli socialist i ekonomisë së centralizuar dhe të planifikuar kishte dështuar plotësisht, përballë modelit kapitalist të bazuar në pronën private dhe tregun e lirë. Ky aspekt nxiti shpërthimin në

mënyrë të pandalshme të idesë

*“për një botë të globalizuar dhe të unifikuar rreth tregut të lirë”.*

Arsyeja e dytë, është rritja e ndërgjegjesimit të njerëzve, kundrejt problematikës mjedisore, duke krijuar një shtrat të favorshëm për tezat ekologjike që duhej të shtriheshin në një shkallë planetare.

Arsyeja e tretë, është se viti 1990 shënoi thellimin e mjaft fenomeneve që kishin për qëllim integrimin ekonomik, tregtar dhe prodhues në shkallë botërore.

Së fundi, duke e vlerësuar së tepërmi procesin e integritit ekonomik, termi “globalizim” u përfshi dhe u përdor nga mjaft organizata, si Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), Banka Botërore apo Organizata Botërore e Tregtisë, duke eliminuar nocionin “ndërkombëtarizim”.

Është më se e qartë tashmë, se të gjithë këta faktorë të përmendur më sipër, i hapën rrugën konceptit “globalizim”, kundrejt konceptit “regull i ri botëror”.

Është për t'u theksuar fakti se, përveç ekonomisë, këtë koncept e përvetësuan edhe shumë disiplina të tjera, sidomos në planin akademik dhe universitar, duke e pasuruar atë me problematikën e tyre. Shumë shkencë, si ato të politikës, historisë, antropologjisë, etnografisë dhe gjeografisë, e bënë globalizmin pjesë të këndvështrimeve të tyre. Në mbështetje të fakteve që shprehëm më sipër, globalizmin mund ta përkufizojmë si shprehës të lidhjeve njeri-natyre, lidhje të cilat ndikojnë në mënyrë tepër të qartë në zhvillimin e globit. Edhe politologët i dhanë një dimension tjetër, duke e cilësuar globalizimin si

*“tregues të rikonfigurimit të rolit të shtetit, në raport me aktorët dhe sfidat e reja”, ose duke e trajtuar në një plan më global, si “një fenomen tipik i marrëdhënieve ndërkombëtare”.*

Tashmë mund të shtrohet me të drejtë pyetja: Në sa profile shfaqet globalizimi në ditët e sotme? Duhet theksuar se, në mënyrë më të dukshme, shfaqet i ashtuquajtur i “globalizimi ekonomik”, i cili lidhet ngushtë me përhapjen në shkallë botërore të shërbimeve që konvergojnë me lëvizjen e jashtëzakonshme të kapitaleve, të fuqisë punëtore, të risive, njohurive teknike dhe teknologjike, krijimi i tregjeve globale, për më tepër, zgjerimi i firmave e kompanive multinacionale dhe i produkteve tashmë të njohura si “made in world” (prodhuar në botë).

Prirja për një përhapje të konceptit global për demokracinë dhe qeverisjen, në funksion të të drejtave të njeriut, duke shtuar së tepërmi

gamën e vendimmarrjeve nga mjaft institucione ndërkombëtare, në raport me ato nacionale, na çojnë natyrshëm tek identifikimi i profilit të “globalizimit politik”, si një nga aspektet më të rëndësishme të gjithë procesit të globalizimit në tërësi.

Një çështje është tepër e rëndësishme për çdo njeri. A duhet të kemi frikë prej tij, apo të bashkëjetojmë me të? Sigurisht, prej këtij procesi ka përfitues të niveleve të ndryshme, por, pse jo, edhe të humbur. Globalizmi duhet konsideruar si një proces bashkëshoqërues i gjithë zhvillimit të njerëzimit. Kështu, atashimi subjektiv me procesin dhe vlerësimi i tij në dy versionet kryesore, pra “pro globalist” dhe “antiglobalist”, është një doktrinë që e njeh dhe e vlerëson maksimalisht ekzistencën e fenomenit të globalizimit, por që synon ta përshpejtojë ose ta frenojë atë.

Ky proces konsiderohet si një integrim i të gjithë popujve të rruzullit tokësor në një organizëm, i cili ka hedhur matanë pengesat e lëvizjes së mallrave, tregtisë, teknologjisë, komunikimit ndërnjerëzor, njohurive, kulturave, gjuhëve etj. Ky proces, për një pjesë të njerëzve, ka sjellë vetëm të mira, në të gjitha nivelet e shoqërisë së çdo shteti të globit. Sikundër ka edhe nga ata që nuk i japin vlera të tilla pozitive.

Se si dhe sa janë të lidhura shtetet aktualisht, në të gjitha fushat e jetës, pasqyrohet më konkretisht në mënyrën interesante se si e ka shpjeguar një revistë ngjarjen tragjike të vdekjes së princeshës së Uellsit, lady Dianës. Ja sa bukur e ka përshkruar këtë ngjarje në prizmin e globalizimit të jetës:

*“Lady Diana angleze dhe miku i saj egjiptian, Dodi El-Fayed, humbën jetën në një tunel francez. Ata po udhëtonin me një veturë gjermane, por me motor holandez, që e ngiste një shofer belg. Mjeti i tyre po ndiqej nga paparacë italianë, hipur në motorë japonezë”.*

Portreti i globalizimit na krijon shumë pikëpyetje për vetë konceptin e zhvillimit, të cilin një pjesë e madhe e popullsisë së globit e koncepton si “stadi më i lartë i imperializmit ekonomik”. Ky aspekt është përshkruar shumë qartë në shprehjen e diplomatit Henry Kissinger, se globalizimi përfaqëson emrin e ri politik të hegjemonisë amerikane. Në shumë komente ekziston një konsensus, se modeli aktual i globalizimit është, në fund të fundit, një realitet dhe krijim amerikan, duke u mbështetur në faktin se

*“historia e veçantë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës mund ta shpjegojë fare qartë këtë aspekt monolitik të ekonomisë botërore”.*

Ky përfundim mbështetet në argumentin se SHBA-ja u krijuan pa përfshirë asnjë lloj kulture e popullsi lokale. Diversiteti kulturor dhe historik, produktet e emigrantëve të shumëllojshëm që shkuan në atë truall, bënë të mundur krijimin e një shoqërie homogjene, të mbështetur në tri kolona tepër të rëndësishme. Konkretisht, në demokracinë, lirinë individuale dhe përgjegjësinë civile. Ekonomia amerikane u zhvillua shumë shpejt, duke prodhuar në masë modele dhe produkte të standardizuara, jo vetëm për SHBA-në, por për mbarë botën.

Shpesh, del në pah një nocion tjetër i këtij fenomeni, duke e konsideruar këtë proces si një “amerikanizim të globit”, kjo për faktin se, duke qenë në krye të shteteve perëndimore në ekonomi dhe kulturë, kjo çon në dominimin e Amerikës ndaj të gjitha shteteve.

Situata e krijuar në planetin tonë shtron para të gjitha shteteve mjaft çështje që kërkojnë zgjidhje, si: A duhet të vazhdojë të jetë modeli amerikan apo perëndimor i zhvillimit dhe konsumit, i vetmi model dominues në shekullin XXI?! A është normale që vetëm një grup vendesh apo institucionesh ndërkombëtare të vendosin për gjithçka në zhvillimin ekonomik-social të botës?! Sigurisht, pyetje të tilla janë tepër të arsyeshme për t’u bërë, por kërkojnë përgjigje të sakta, sepse në planetin tonë po dalin në pah mjaft shtete, të cilat kanë bërë hapa të shpejta dhe të mëdha në glob.

Duhet theksuar se, krahas termit “globalizim”, kur bëhet fjalë për aspektin ekonomik- financiar, shpesh përdoret edhe termi “triadizim”, në përbërje të të cilit përfshihen Amerika e Veriut, Evropa Perëndimore dhe Japonia. Ky emërtim nuk është thjesht një identifikim gjeografik i globalizimit, por mbështetet në faktin se intensiteti më i madh ekonomik zhvillohet ndërmjet tri poleve ose rajoneve të botës: Amerikës së Veriut, Europës Perëndimore dhe Japonisë. Konkretisht, mbi 80% e kapitaleve botërore, mbi 90 % e marrëveshjeve strategjike të bashkëpunimit ekonomik e tregtar, apo mbi 70% e eksporteve botërore zhvillohen nga këto vende. Pra, pak a shumë, këto shtete janë përfituesit kryesorë.

Nuk duhet lënë pa përmendur se konkurrent shumë dinjitoz në aspektin e bashkëpunimit ndërshtetëror konsiderohet edhe BRIK-u, i cili nënkupton bashkëpunimin e katër shteteve mjaft të fuqishme, që janë Brazili, Rusia, India dhe Kina, shtete këto që kanë marrë një zhvillim të konsiderueshëm në të gjitha fushat e jetës. Nga këto katër shtete, Kina ka pasur një zhvillim të madh, sidomos vitet e fundit, duke marrë në konsideratë se, pas vitit 2030, ajo edhe mund të zërë vendin e parë në prodhimin e përgjithshëm ekonomik botëror.

Një tjetër pyetje mund të shtrohet se si mund të qeveriset globalizmi. Këtë aspekt në vija të përgjithshme e ndjekin mjaft institucione të nivelit botëror, të cilat konsiderohen si përgjegjëset kryesore të menaxhimit të globalizmit. Kështu, lindin dyshimet, nëse mund të krijojë FMN-ja, me rolin dhe vendimet e saj, stabilitetin e nevojshëm financiar ndërkombëtar. Po a mundet që Banka Botërore ta luajë si duhet rolin e saj për nxitjen e zhvillimit ekonomik-social, në mënyrë të ekuilibruar në të gjitha vendet e globit? Po ashtu, Organizata Botërore e Tregtisë, a është e aftë të vendosë në mënyrë dinjitoze rregulla tregtare ndërkombëtare, në shërbim edhe të vendeve të varfra dhe atyre në zhvillim? Po Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB), a po vepron në përputhje me interesat themelore të të gjitha vendeve të botës, apo ajo ndikohet nga interesat specifike të pesë vendeve që përbëjnë Këshillin e Sigurimit dhe kanë të drejtën e vetos në marrjen e vendimeve?

Në rrethana të tilla, shpesh efektiviteti i këtyre institucioneve, përballë globalizmit, shikohet me mosbesim nga shumë popuj e vende të botës dhe është normale të mendohet, nëse faji për këtë iu takon këtyre institucioneve. Sigurisht një qeveri botërore është e pamundur, por po bëhen propozime në dy drejtime: Së pari, institucionet ndërkombëtare të forcohen dhe të përmirësojnë punën e tyre, duke i rritur kompetencat. Së dyti, të propozohen dhe të ngrihen institucione të reja ndërkombëtare.

## Koronavirusi – Covid -19

Në fillim të vitit 2020, në tërësinë e planetit tonë u përhap një virus i cili pati shtrirje shumë herë më të madhe sesa elementet e tjera të globalizmit. Ja si ndodhi ky fenomen. Ishte muaji janar i vitit 2020, kur u shfaq në Itali një virus i padëgjuar më parë, që mori emrin “koronavirusi – Covid-19”. Ai filloi të shtrihej gjerësisht, kryesisht në zonën e Lombardisë, duke infektuar shumë njerëz. Njëherësh, infektimi ishte shumë i rrezikshëm, me pasojë vdekjen e qindra njerëzve çdo ditë.

Gradualisht, ky virus u përhap në të gjithë globin dhe deri në muajin janar 2021, numri i të prekurve nga koronavirusi ka shkuar në mbi 99 milionë e 774 mijë. Numri i personave që kanë humbur jetën, për shkak të virusit, është rritur në 2.139.031, ndërsa numri i personave të prekur që janë shëruar ka arritur në 71.762.746. SHBA rezultoi vendi më i prekur nga pandemia, me gjithsej 25.702.125 raste dhe 429.490 jetë të humbura.

Këto janë shifra mjaft të larta brenda një kohe shumë të shkurtër. Duhet theksuar se ky cikël i infektimit akoma nuk është mbyllur. Përveç

dëmeve njerëzore, janë evidentuar edhe dëme të mëdha ekonomike të cilat, sipas kohëzgjatjes, mund të jenë shumë të mëdha. Me të drejtë, mund të shtrohet pyetja, se cilat shtete kanë qenë më pak të prekura dhe cilat më të goditura.

Më pak e prekur nga kjo pandemi rezultojnë të jetë Koreja e Veriut. Bie në sy fakti se, në një listë shtetesh prej 215 vendesh, ku tregohen shifrat e të infektuarve dhe të vdekurve, vetëm Koreja e Veriut nuk përfshihet, ndërsa Koreja e Jugut zë vendin e 56-të, me 12 085 të infektuar dhe 34 të vdekur (deri më 15 qershor 2020). Sigurisht, mosnjohja e realitetit shpjegohet falë sistemit të mbyllur dhe mosdeklarimit të të dhënave. Nuk bëhet fjalë për ndonjë shifër konkrete të të infektuarve dhe të vdekurve, por një gjë është e sigurt, që në një shtet me rreth 25 milion banorë, situata nuk është aspak e njëjtë, jo vetëm kundrejt Koresë së Jugut si shtet fqinj, por kundrejt të gjitha shteteve në planet.

Është më se e qartë, se arsyeja pse është më pak i goditur ky shtet, është se shteti i Koresë së Veriut, si vazhdues ideal i regjimit monist, është i izoluar nga të gjitha shtetet e tjera, pra shkalla e kontaktit është në minimumin e mundshëm, që për problemin e pandemisë në fjalë rezultojnë të jetë me vlera pozitive, duke pasur parasysh problemet e mëdha që kanë vendet e tjera. Njëherësh, nuk do të jetë i vogël problemi i rënies ekonomike, edhe kur kjo pandemi të konsiderohet e mbyllur.

Çështjen e përhapjes me kaq shpejtësi të këtij virusi e ka trajtuar qartë virologia e njohur italiane, Ilaria Capua, kur thotë:

*“Ne e lejuam virusin që të hipte në aeroplan dhe të udhëtonte në gjithë planetin. Brenda një jave virusi u përhap në 5 kontinente”.*

Duke e shpjeguar virologia përhapjen në këtë mënyrë, a nuk tregon ky fakt, se edhe ky virus mund të konsiderohet një element komunikimi në të gjitha aspektet e jetës, si pasojë e globalizimit?!

Ky fenomen të çon në përfundimin se asnjë sistem nuk mund të konsiderohet “100 % më i miri”, fakt ky që edhe më parë dihej, por kjo pandemi sikur i vuri vulën. Me të drejtë, shtrohet pyetja: A ka ndonjë aspekt pozitiv përhapja e infeksionit dhe njëherësh karantinimi i njerëzimit? Sigurisht që janë evidentuar disa vlera të bashkëjetesës së njerëzimit, por, në përputhje me këto ngjarje, a mund të thotë dikush (përveç Kim Young Un), se sistemi monist me ekonomi të centralizuar, i zbatuar në Korenë e Veriut, duhet të konsiderohet sistemi më i mirë? Sigurisht që askush nuk mund ta pranojë këtë, madje edhe vetë populli i Koresë së Veriut nuk e thotë një pohim të tillë me ndërgjegje, por një ngjarje e tillë i vjen

për shtat Kimit dhe përkrahësve të tij. Duke marrë në konsideratë dëmet njerëzore dhe ekonomike, dëme të cilat do të jenë shumë të mëdha, edhe pas përfundimit të kësaj pandemie, kjo të bën të mendosh se këtij “globalizimi” të jetës aktuale i duhet shtuar edhe një element i ri. Ky element nuk ka vlera pozitive, megjithatë, shoqëria njerëzore në rruzullin tokësor duhet të vazhdojë në këtë proces, por vetëm se duhet të jetë më e vëmendshme ndaj këtij elementi, pse jo, edhe ndaj të tjerave, siç mund të jenë edhe ato sociale, pasi nuk mund të përgjithësohen të gjithë popujt në një kulturë të vetme.

Mbi dukurinë e keqpërdorimit të këtij virusi në prizmin e analizave dhe komenteve, mund të thuhet se janë bërë komente me përmbajtje shumë negative dhe mjaft të politizuara:

- Është diskutuar në shumë këndvështrime origjina e këtij virusi, është me origjinë natyrale nga lakuriqi i natës, apo është krijuar në laboratorin e Wuhanit.
- Është me origjinë nga Kina, apo i infektuari zero ka qenë ushtaraku amerikan që ishte në Wuhan.
- U përhap në Itali në muajin mars 2020, apo që në dhjetor 2019, janar 2020, apo edhe më herët.
- Të gjitha rastet e vdekjeve në këto tre-katër muaj kanë qenë si rezultat i infektimit nga Covid-19, apo janë edhe për shkaqe të tjera sëmundjesh.
- A mori angazhim serioz Bashkimi Evropian (BE) për të ndihmuar Italinë me aparatura mjekësore, apo u tregua indiferent? Ka shumë komente se BE-ja nuk tregoi interesim, fakt ky që e dëmton së tepërmi bashkëpunimin ndërmjet shteteve evropiane. Si institucion tepër i konsoliduar, Bashkimi Evropian po tregon shenja plasaritjeje, të cilat mund të mos përkeqësohen, por edhe për kaq sa ndodhi, mjafton.
- Shumë akuza dhe komente denigruese janë bërë kundër Bill Gates, duke e akuzuar atë si ideator të krijimit të këtij virusi, në mënyrë që ai të kontribuonte në përgatitjen e vaksinës parandaluese të infektimit dhe njëherësh, në prodhimin e medikamentit shërues ndaj këtij virusi.
- Një grup mjekësh gjermanë kanë bërë një deklaratë të fortë, që ngre dyshimet se Covid-19 është vetëm një mashtrim, pasi, sipas tyre, ai është si të gjithë viruset e tjera.

Duke e parë çështjen me syrin optimist, mund të thuhet se kjo pandemi, mund të bëhet shkaku i prodhimit të disa rezultateve pozitive në politikë. Ajo i dha popujve një përvojë të re menaxhuese, për ta njohur dhe njëherësh për ta menaxhuar këtë të keqe. Specialistët e mjekësisë bënë me të vërtetë një hap të rëndësishëm përpara, duke kaluar në një profesionalizëm mjaft cilësor, sikundër u zbuluan edhe mjaft mangësi menaxhuese. Kjo krizë shtroi nevojën e bashkëpunimit institucional jo vetëm brenda vendeve, por edhe ndërmjet vendeve të ndryshme.

Kam përshtypjen se Organizata Botërore e Shëndetësisë nuk ka luajtur rolin që i takon, si organizatë tërëplanetare që është. Ka pasur dhënie idesh dhe mendimesh nga më të ndryshmet, por tejet kontradiktore me njëra-tjetrën. Diskutimet kanë qenë të tilla, saqë disa qarqe dhe njerëz këtë virus e quanin lojë. OBSH kishte për detyrë të mblidhte të gjitha opinionet e mjekëve, biologëve dhe shkencëtarëve të ndryshëm, dhe duhet të dilte në një përfundim të vetëm dhe me orientime të përqendruara. Dikush thotë se është i rrezikshëm, dikush tjetër thotë se nuk është i rrezikshëm; dikush thotë se do të zhduket në verë e dikush jo etj. Një qëndrim i vetëm dhe i saktë do të bënte që njerëzit e të gjithë planetit të ishin më të qetë dhe më të orientuar.

Në fakt, mund të ketë pasur edhe akuza apo komente të tjera, por nuk po e zgjasim më tej, pasi përmendja e tyre është bërë për të treguar se përhapja e këtij virusi bëri të mundur që në shtetet “partizane” të globalizmit, të futej një “e keqe” që mund të dëmtojë ecjen përpara të këtij globalizimi. Por, nga ana tjetër, nxori në pah, jo se nuk dihej, kapacitetin në rritje të Kinës në aspektin ekonomik, e cila do të jetë kandidatë për të marrë kryesimin e procesit të globalizimit, pasi atë të BRIK-ut pothuajse e ka marrë. Pra, duhet theksuar se ky virus zbuloi shumë fakte të ditura, por jo të vërtetuara, të ekzistencës së kontradiktave midis shteteve me potencial të lartë ekonomik. Ecurinë e mëtejshme të bashkëpunimit të shteteve do ta shikojmë në vijim, në vitet e ardhshme, por shenjat janë se nuk mund të shkohet drejt një rendi të ri botëror, nën drejtimin e atyre grupeve që konsiderohen si shoqëri të fshehta, pasi kanë dalë në pah shtete që nuk merreshin në konsideratë nga këto shoqëri.

Efektin negativ të përdorimit të këtij virusi e ka shtjelluar shumë qartë Janusz Bugajski:

*“Tashmë, dihen veprimet e terroristëve në botë, duke përdorur mjete të ndryshme për shfarosjen e njerëzve. Efekti veprues i këtij virusi ndaj qenieve njerëzore u pa qartë se është goxha i fuqishëm dhe njëherësh, ka vetinë të përhapet shumë shpejt në mjediset me*

*njerëz. Mirëpo tani, duke parë mundësinë e prodhimit të këtij virusi dhe duke pasur parasysh se, për hir të globalizimit, njerëzit lëvizin lirshëm nga një shtet në tjetrin, terroristët, duke zotëruar mjetet financiare, mund të prodhojnë lloje të ndryshme virusesh dhe t'i përhapin në ato zona ku ata duan të godasin njerëzimin”.*

## Pandemitë ndër shekuj

Siç e theksuam, i gjithë globi është përfshirë nga kjo pandemi, duke shkaktuar dëme dhe shqetësime të mëdha. Por kjo pandemi nuk është e para që ka ndodhur në planetin tonë. Pandemia e parë e dokumentuar, ka qenë murtaja e Athinës, në vitet 400 (p.e.s.), që ka ndodhur gjatë luftës së Peloponezitet, e cila zgjati 4 vite dhe shfarosi një të katërtën e popullsisë.

Rreth 500 vite më vonë, një tjetër murtajë preku botën në vitet 165-180 (e.s.), duke shkaktuar rreth 5 milion viktima.

Murtaja e Justinianit nisi në vitin 541, në Etiopi dhe Egjipt, duke u përhapur në Turqi dhe Europë për 209 vite rresht. Shënoi rreth 10.000 viktima brenda ditës në Konstandinopojë. Kjo murtajë pati rikthime, ndër të cilët më i madhi në Francë, duke shënuar 25 milion të vdekur.

Vdekja e zezë që shkaktoi 75 milion të vdekur, nisi që nga Azia, në vitin 1331, dhe vazhdoi në Evropë. Cikli i saj zgjati mbi 20 vjet. U rikthye here pas here dhe në total vrau 137 milion njerëz.

Pandemia e kolerës në vitin 1817 ose infeksioni i zorrëve që filloi në Rusi, nga i cili vdiqën 1 milion njerëz.

## Situata në 100 vitet e fundit

Në kohët moderne kanë ndodhur 2 pandemi. Gripi spanjoll, në vitet 1918-1920, preku disa shtete në Evropë, SHBA dhe Afrikë. Shkaktoi 500 milionë infektive dhe mbi 25 milionë të vdekur, shifër më e madhe sesa viktimat e Luftës së Parë Botërore.

Në vitin 1957, gripi aziatik, i shkaktuar nga virusi H2N2, vrau 2 milionë njerëz, por u mposht me shpikjen e vaksinës.

Ebola, në vitet 2013-2016, në Afrikën Perëndimore, shkaktoi 11.300 vdekje në Guine, Liberi, Sierra Leone.

Gripi i dërrit ose H1N1, në vitet 2009-2010, shkaktoi 18.500 të vdekur vetëm në Meksikë dhe SHBA. Gjithsej në botë, humbën jetën 151.700 – 575.400 njerëz.

Sars –Sindromi i frymëmarrjes, u shfaq fillimisht në vitin 2002-2003, Guangdong të Kinës Jugore. Virusi u përhap te njeriu nga lakuriqi i natës. Prej tij vdiqën rreth 774 vetë në Kinë dhe Hong-Kong dhe infeksioni u përhap në rreth 30 vende. Vdekshmëria shkoi 9.5 %.

Gripi i shpendëve – H5N1, i vitit 2003 – 2004. Virusi vdekjeprurës i gripit të shpendëve mbyti më shumë se 400 persona, kryesisht në Azinë Juglindore. Virusi filloi nga një fermë zogjsh në Hong, para se të transferohej te njerëzit. OBSH shpalli gjendje të jashtëzakonshme.

## Dritëhijet e kapitalizmit kinez

Sipas studiuesit amerikan, Robert E. Gamer, idetë e të cilit paraqiten në librin e tij “Governments and Politics in a changing World”, format e regjimit që po ekzistojnë në botë, në këto vite pas shembjes së regjimeve diktatoriale moniste me ekonomi tregu të përqendruar, janë: sistemet presidenciale, sistemet monarkiste, sistemet parlamentare, sistemet ushtarake, shtetet teokratike dhe sistemet moniste.

Në këtë kuadër, do të theksonim se, në aspektin politik, sistemi monist dhe me ekonomi të centralizuar përfaqësohet “denjësisht” nga Koreja e Veriut, e drejtuar me dorë të hekurt nga i famshmi Kim Young Un. Mirëpo, aty pranë me Korenë e Veriut, ndodhet edhe një shtet tjetër monist, por me një ndryshim, se nuk ka ekonomi të centralizuar, por ekonomi tregu të lirë dhe ky shtet është Republika e Kinës.

Kinezët theksojnë me bindje, se modeli i tyre politiko-ekonomik është një model i veçantë dhe, me të vërtetë, ky pretendim është i tillë, pasi nuk mund të përfshihet as në sistemin parlamentar me ekonomi tregu, por as në atë monist klasik, të klasifikuar nga R. E. Gamer, pasi është një kombinim i tyre në aspektin politiko-ekonomik. Kina, në vitin 1949, shënoi fillimin e një shteti monopartiak, me ekonomi të centralizuar socialiste, ku partia luante rol vendimtar, duke mbajtur nën kontroll ekonominë e vendit. Ndërsa pas vitit 1990, ata zhvilluan një sistem të ri në ekonomi, duke mbajtur të paprekur aspektin politik, pra atë njëpartiak. Edhe pse shoqëria kineze nuk ka arritur të rregullojë në nivelin e duhur situatën ekonomike të gjithë popullatës së saj prej 1 miliard e 400 milionëshe, prapë se prapë, një përmirësim duket se ka. Më parë thuhej se kinezët në shumicë konsideroheshin se jetonin mirë, nëse hanin nga një tas me oriz, ndërsa tani ai tas të paktën mund të jetë dyfishuar. Në aspektin global, Kina si shtet ka bërë përparime të dukshme dhe ka filluar prej kohësh të konkurrojë edhe SHBA-në. Prodhimi i përgjithshëm i Kinës, në vitin 2018, llogaritej 13.61 trilionë dollarë. Pikërisht, rasti i përhapjes

së koronavirusit dhe përplasjet me SHBA-në, nxorën si faktor përcaktues, faktin se Kina është forcuar së tepërmi si shtet.

Mund të shtrohet pyetja, nëse sistemi aktual politiko-ekonomik i Republikës së Kinës mund të konsiderohet sistem i një tipi të ri. Dhe nëse po, a mund t'i shtohet grupit të gjashtë sistemeve që prezanton Prof. Garner, duke e çuar në shtatë numrin e tyre? Këtë përgjigje le ta japin politologët dhe ekonomistët por, mesa shihet, kjo edhe mund të qëndrojë. Këtë pyetje mund ta shtrojnë shtetet ish-diktatoriale, të cilat, pas përmbysjes së sistemit diktatorial, i kthyen shtetet e tyre në pluralizëm, me ekonomi tregu të lirë. Pra, çdo të ndodhte nëse do të mbeteshin (si Kina) politikisht në monizëm, por me ekonomi tregu të lirë? A do të kishin bërë hapa më të sigurt përpëra, apo Kina është rast unikal?!

## Bibliografia

1. Paul C. Yong's - Christian Book Series.
2. Ardian Civici - Globalizimi ..... Ante Portas.
3. Janusz Bugajski - Rreziku i terrorizmit nëpërmjet pandemisë.
4. Ilaria Capua - përhapja e virusit në planet.
5. Robert Garner – Governments and Politics in a changing world.
6. Lajme të ndryshme nga mediat.